



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 733/15 prot.

Datë 28.05.2025

V E N D I M

Nr. 715/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.05.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 572/2025, datë 29.04.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.

Ankimues: Operatori ekonomik (BOE) “Alko Impex Construction” SHPK & “Alko-Impex General Construcion” SHPK, përfaqësuar nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK me NIPT K91628013D dhe adresë: Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga Asim Vokshi , Alb building 2t, kati i 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Dibër.
Adresa: Bulevadi “Elez Isufi”, Peshkopi.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “Liqeni VII” SHPK me NIPT K01730502Ë dhe adresë Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozë, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datë 29.04.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.572/2025, ku vendosi: [...]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.
2. Autoriteti kontraktues të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër..
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera dhe duke dërguar dokumentat e reja të procedurës së prokurimit të modifikuara sipas konstatimeve të mësipërme.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion ” SHPK
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1.2 Me shkresën nr. 1632/1 prot., datë 22.05.2025, protokolluar me tonën nr. 733/12 prot., datë 26.05.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 572/2025, datë 29.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.

II**Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 1632/1 prot., datë 22.05.2025, protokolluar me tonën nr. 733/12 prot., datë 26.05.2025 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 572/2025, datë 29.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” & “Alko-Impex General Construcion” SHPK dhe ka anuluar procedurën e prokurimit, në përputhje me vendimin Nr. 572/2025, datë 29.04.2025 të këtij Komisioni. Gjithashtu, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor nuk i ka bashkëngjitur shkresës së mësipërme dokumentat e reja të procedurës së prokurimit të modifikuara sipas konstatimeve të shprehura në vendimin nr.572/2025 të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 15 pika 1 e ligjit nr Nr. 8480, date 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur,” me nr. REF-34999-12-31-2024, me objekt: “Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Demir Gashi, Bashkia Diber 2024”, me fond limit 118,385,642.50 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 21.01.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Diber.
2. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të paraqesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentat e reja të procedurës së prokurimit të modifikuara në zbatim të vendimit të sipërpërmendur.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

